

VENDIM
Nr.41, datë 26.10.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
"ALBSIG" SHA PËR 6- MUJORIN E PARË TË VITIT 2005

Në mbështetje të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës së Sigurimeve", të nenit 98, nenit 107 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës i Sigurimeve

VENDOSI:

1. T'i kërkojë shoqërisë së Sigurimit ALBSIG sh.a. të autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për ushtrim aktiviteti në sigurime me nr.10, datë 19.7.2004 dhe me leje të ushtrimit të aktivitetit në sigurime më 10/1, datë 10.9.2004, që brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për mbulimin e përgjegjësive që rezultojnë mbi mundësitë e saj siç parashikohen nga neni 107 i ligjit të sipërpërmendur:

a) Të marrë masa për risigurimin, rritjen e kapitalit themeltar në nivelin e kërkuar dhe të depozitojë në llogarinë qëllimore fondin e kërkuar të garancisë.

b) Në rast të mospërbushjes të kërkesave të pikës 1/a, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjësive të marra, që janë në tejkallim të kërkesave të nenit 107 të ligjit të sipërpërmendur.

2. Në rast të mospërbushjes të kërkesave të pikës 1, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjësive të marra, që janë në tejkallim të kërkesave të parashikuara në nenin 107 të ligjit nr.9267 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

3. Të zhblllokojë pjesën e fondit të garancisë së përdorur si kolateral për kredi të marra në banka tregtare.

4. Ngarkohet shoqëria ALBSIG sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me datë 26.10.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba